



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT  
Seksioni i Veçantë



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot.  
Nr. Dok. 201601348/6

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2016

**Lënda :** *Rekomandim për trajtimin human dhe me etikë të shtetasve të shoqëruar apo arrestuar gjatë kryerjes së veprimeve në ambientet e policisë.*

**Drejtuar :** Drejtorit të Drejtorisë Vendore të Policisë  
Z. Alfred ÇEPE

Elbasan

I nderuar zoti Çepe,

Në Institucionin e Avokatit të Popullit kanë bërë ankesë familjarët dhe avokatët mbrojtës të shtetasve A.Ç., F.Ç., B.M., A.S. dhe F.M.. Ata pretendojnë se, në datën 08.06.2016, në qytetin e Elbasanit, ka ndodhur një shkëmbim me armë zjarri ndërmjet punonjësve të Policisë së Shtetit dhe disa personave. Në këtë datë janë arrestuar disa shtetas të dyshuar si autorë të ngjarjes dhe më pas janë dërguar në ambjentet e Drejtorisë Vendore të Policisë Elbasan. Ndërmjet të arrestuarve janë edhe shtetasit e cituar më sipër. Sipas ankuesve, ndaj tyre është ushtruar dhunë fizike nga punonjës të policisë të Repartit të Ndërhyrjes së Shpejtë Tiranë. Gjithashtu ankuesit kanë ngritur edhe pretendimin se gjatë qëndrimit dhe pyetjes së të arrestuarve në ambientet e Drejtorisë Vendore të Policisë Elbasan ju janë marrë veshjet e tyre dhe kanë ngelur të zhveshur në pjesën e sipërme të trupit për disa orë. Ndërkohë ankuesit pretendojnë që familjarët e tyre kanë shkuar në organin e policisë dhe kanë sjellë veshje, por ato nuk janë lejuar që të futen.

Gjatë takimit të bërë nga përfaqësuesit e institucionit tonë me Zëvendësdirjtorin e Policisë Vendore Elbasan z. Hita, në datën 11.06.2016 u informuam se, të arrestuarve ju janë hequr e marrë disa veshje, sepse ato janë sekuestruar me cilësinë e provës me qëllim ekzaminimin e tyre kriminalistik (kimik) për të vlerësuar faktin nëse në to gjenden apo jo faktorë plotësues të qitjes. Ndërkohë ai mohoi faktin që familjarët e të arrestuarve kishin sjellë rroba dhe se ato nuk ishin lejuar që tu jepeshin për ti veshur.

Përveç sa më sipër, shtetasit A.Ç., F.Ç., B.M., A.S. dhe F.M. gjatë pyetjes nga ana e punonjësve tanë në datën 14.06.2016 kanë ngritur edhe pretendimin se, nuk u janë dhënë kopje të procesverbaleve të arrestimit në

flagrancë dhe të kontrollit personal. Mirëpo nga ana jonë nuk u bë i mundur që të provohej ky pretendim i tyre.

Nga shqyrtimi i këtyre ankesave arritëm në konkluzionin se, marrja dhe sekuestrimi i veshjeve personave të arrestuar është veprim i bazuar në ligj. Ndërsa lënia e tyre në gjëndje të zhveshur për disa orë nuk është veprim human dhe etikë. Gjithashtu lënie e tyre në gjëndje të zhveshur për disa orë përbënte rrezik për dëmtimin e shëndetit për shkak të ftohjes. Ne gjykojmë se, punonjësit e policisë që kanë kryer veprimet procedurale me të arrestuarit në rastin konkret duhet të komunikojnë me familjarët e tyre dhe t'u kërkonin dërgimin e veshjeve të tjera me qëllim që ata të mos mbeteshin të zhveshur në ambientet e policisë gjatë kryerjes së veprimeve me ta.

Ky veprim i punonjësve të policisë cënon imazhin dhe reputacionin e organit të Policisë së Shtetit dhe njëkohësisht trondit besimin e publikut tek ky organ.

Për sa më sipër dhe me qëllim parandalimin e rasteve të tilla në të ardhmen, bazuar në pikën 3 të nenit 63 të Kushtetutës ku thuhet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”* dhe në gërmën “b” të nenit 21 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, i ndryshuar, ku parashikohet se: *“Pas përfundimit të hetimit, Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”*,

## **REKOMANDOJMË**

1. Analizimin e këtij rasti dhe nxjerrjen e përgjegjësive konkrete ndaj punonjësve të policisë që i kanë kryer këto veprime.

2. Përgjithësimin e këtij rasti në organet dhe strukturat e policisë në varësi të Drejtorisë Vendore të Policisë Elbasan, me qëllim që raste të tilla të mospërsëriten më në të ardhmen në organet tuaja.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, lutemi të na ktheni përgjigje brenda afatit ligjor prej 30 ditësh të parashikuar në nenin 22 të ligjit “Për Avokatin e Popullit”.

*Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,*

**K O M I S I O N E R I**

**Arben SHKËMBI**